

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXI, nr. 6445
E enjte, 21 tetor 2021
çmimi 0.40 €

Ekonomia e Kosovës pritet të rritet në 9.9 për qind për vitin 2021



Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

SHEFI I ZYRËS I BASHKIMIT EVROPIAN NË PRISHTINË, TOMAS SZUNYOG, UA KA DORËZUAR PËRFAQËSUESVE TË INSTITUCIONEVE TË KOSOVËS RAPORTIN E PËRPARIMIT TË PËRPILUAR NGA KOMISIONI EVROPIAN

KOSOVA ZOTOHET SE DO T'I REALIZOJË PRIORITETET E DALA NGA RAPORTI I PROGRESIT



Shefi i Zyrës i Bashkimit Evropian në Kosovë, Tomas Szunyog, ka takuar ndaras presidenten e Kosovës, Vjosa Osmani, kryeparlamentarin Glauk Konjufca dhe kryeministrin Albin Kurti, të cilëve ua ka dorëzuar raportin e Komisionit Evropian për Kosovën. Ata janë zotuar se do t'i realizojnë prioritetet e dala nga raporti i progresit. Ndërkaq presidentja Osmani ka kërkuar sqarime nga shefi i BE-së në Prishtinë për moskonsultimin e institucionit të Presidencës në fazën para hartimit të raportit, siç janë konsultuar të gjitha institucionet e tjera dhe shoqëria civile

BIE NUMRI I PACIENTËVE ME COVID TË SHTRIRË NË SPITALET E KOSOVËS



SHBA-ja DHE BE-ja MBËSHETIN ANGAZHIMIN E KOSOVËS PËR LUFTIM TË KORRUPSIONIT DHE KRIMIT TË ORGANIZUAR

OPINION

LËRINI FYERJET, BASHKOHUNI PËR MBROJTJE TË SHTETIT!



AKTUALE



MBROJTJA KËRKON LIRIMIN E HYSNI GUCATIT NGA PARABURGIMI

BE-ja: TË ENJTEN TAKOHET GRUPI PUNUES PËR TARGAT

SA ËSHTË I SIGURT USHQIMI NË KOSOVË?

EKONOMI



KURTI VIZITON "TREPÇËN", RIKONFIRMON PËRKRAHJEN PËR NDERMARRJEN DHE PËR MENAXHMENTIN

SPORT



GJILANI E ZBRET DRENICËN NGA FRONI

RENOVA
PUTZ
Macedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.PK.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Mbrojtja kërkon lirim të Hysni Gucatit nga paraburgimi

HAGË, 20 TETOR - Përmes një parashtrës drejtuar trupit gjykues, mbrojtja e Hysni Gucatit ka kërkuar lirim të këtij të fundit nga masa e paraburgimit. Gucati po akuzohet bashkë me Nasim Haradinajn për vepra penale kundër administrimit të drejtësisë, raporton "Betimi për Drejtësi".

Gjykimi në këtë rast ka nisur më 7 tetor, kurse më 18 tetor dëgjimi i dëshmitarëve së parë, e cila dëshminë e saj e ka vazhduar edhe të mërkurën.

Hysni Gucati, së bashku me Nasim Haradinajn, po akuzohen për vepra penale kundër



administrimit të drejtësisë, konkretisht për pengim të personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare, për frikësim të

dëshmitarëve, për hakmarrje dhe për shkelje të fshehtësisë së procedurës, raporton "Betimi për Drejtësi". "Akuzat e

paraqitura në aktakuzën e konfirmuar mbështeten në dyshimin e bazuar mirë se së paku midis 7 dhe 25 shtatorit 2020, z. Gucati dhe z. Haradinaj zbuluan pa autorizim informacion të mbrojtur prej Ligjit të Dhomave të Specializuara, ndër të cilat të dhëna identifikuese të disa dëshmitarëve (të mundshëm), në tri konferenca shtypi dhe aktivitete të tjera të transmetuara, si edhe përmes shpërndarjes së mëtejshme ku përfshihen deklaratat në rrjetet sociale", thuhej në njoftimin e Dhomave të Specializuara.

Gucati dhe Haradinaj ngarkohen se kanë bërë komente nënçmuese kundër dëshmitarëve të mundshëm dhe në mënyrë të përsëritur shprehën synimin e tyre për ta dëmtuar punën e Dhomave të Specializuara. "Me këto veprime, z. Gucati dhe z. Haradinaj shkelën fshehtësinë e procedurës dhe frikësuan dëshmitarë (të mundshëm) të Zyrës së Prokurorit të Specializuar dhe, si pasojë, penguan punën dhe hetimet e ZPS-së", thuhej në njoftimin e Dhomave të Specializuara të Kosovës.

Ish-ushtarët gjermanë arrestohen pas dyshimeve për komplot terrorist

BERLIN, 20 TETOR - Dy ish-ushtarë gjermanë janë arrestuar nën dyshimet për tentim të formimit të një force terroriste mercenare për t'u përfshirë në luftën civile në Jemen, kanë thënë prokurorët.

Arend-Adolf G dhe Achim A përballen me akuza për terrorizëm pas bastisjeve policore në jug të Gjermanisë të mërkurën. Ata dyshohet se kanë planifikuar që të rekrutojnë 150 burra për një ushtri private, të formuar nga ish-zyrtarë

policorë dhe ushtarë. Ata kanë dëshiruar që të ofrojnë shërbimet e tyre për Qeverinë e Arabisë Saudite për misione ilegale në Jemen, kanë thënë prokurorët.

Jemeni është përballur me luftë civile në mes të qeverisë së përkrahur nga Arabia Saudite dhe Lëvizja e armatosur Huthi prej vitit 2014. Arabia Saudite është përfshirë në luftën civile më 2015, pak pas zotërimit të kryeqytetit Sanaa nga Lëvizja Huthi, e përkrahur nga Irani.



Ish-ushtarët e akuzuar kanë kërkuar që Arabia Saudite t'i financojë operacionet e tyre private në Jemen, kanë thënë prokurorët në Gjermani.

Revista gjermane "Spiegel", e cila ka raportuar e para për arrestimet, ka thënë se forca mercenare ishte supozuar që të sulmonte dhe t'i zotëronte zonat që kanë nën kontroll rebelët Huthi në Jemen.

Ish-ushtarët pritet të paraqiten para gjykatës ditën e mërkurë, rreth masës së paraburgimit.

Navalny fiton Çmimin Sakharov

MOSKË, 20 TETOR - Udhëheqësi i burgosur i opozitës ruse, Aleksei Navalny, ka fituar Çmimin Sakharov për Lirinë e Mendimit. Çmimi vjetor i Parlamentit Evropian iu dha atij për, siç u tha, ekspozimin e korrupsionit në Rusi dhe të përpjekjeve për frenimin e lirive në këtë vend.

Navalny ishte në listë të ngushtë me një grup të grave afgane dhe me një politikan opozitar të Bolivisë. Ai u shpall fitues nga ligjvënësit evropianë, njoftoi Partia Popullore Evropiane, e cila është subjekti më i madh politik

në Parlamentin Evropian.

Navalny, një nga kritikët më të zëshëm të presidentit rus Vladimir Putin, është burgosur në një aeroport të Moskës në janar, menjëherë pasi është kthyer nga Berlina, ku është shëruar nga helmimi me agjent nervor.

Bashkimi Evropian ka vendosur sanksione ndaj zyrtarëve rusë për helmimin dhe burgosjen e tij. Navalny, 45 vjeç, është dënuar pastaj me dy vjet e gjysmë burgim për, siç është thënë, shkelje të lirit me kusht.

Ai ka thënë se akuzat kundër tij janë të motivuara politikisht.

Vitin e kaluar Çmimi Sakharov i është dhënë opozitës demokratike të Bjellorusisë, e cila ka organizuar disa protesta kundër udhëheqësit autoritar bjellorus, Alyaksandr Lukashenka. Fituesit e mëparshëm të këtij çmimi përfshijnë: ish-presidentin e Afrikës së Jugut, Nelson Mandela, opozitën demokratike të Venezuelës dhe aktivisten pakistaneze të arsimit, Malala Yousafzai.



Britania regjistron numrin më të madh të viktimitave nga Covid-19 prej marsit



LONDËR, 20 TETOR - Numri i viktimitave me koronavirus në Britani të Madhe është rritur në shkallën më të lartë prej muajit mars. Autoriteti i Statistikave në këtë shtet ka raportuar se 223 persona kanë vdekur brenda 28 ditëve të testimit pozitiv në

Covid-19, sëmundjen që shkakton koronavirusi. Kjo ka qenë shifra më e lartë e viktimitave brenda një dite, prej 9 marsit, kur janë regjistruar 231 viktima. Shifra totale e viktimitave ka shkuar në 138 852.

Të hënën janë regjistruar gati 50 000 raste të reja me koronavirus.

Deri më tani qeveria britanike ka diskutuar pak për mundësinë e kthimit të masave kufizuese. Në Britani masat si vendosja e

detyrueshme e maskës në ambiente të brendshme, kërkesa për vaksinim, apo test negativ në koronavirus, janë shfuqizuar në muajin korrik. Deri më tani 79 për qind e popullatës prej 12 vjeç e tutje janë imunizuar plotësisht kundër koronavirusit.

ShBA-ja dhe BE-ja mbështesin angazhimin e Kosovës për luftim të korrupsionit dhe krimin të organizuar

EPOKA
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 20 TETOR - Bashkimi Evropian dhe Shtetet e Bashkuara "janë pajtuar për ta forcuar angazhimin e përbashkët në Ballkanin Perëndimor në mbështetje të progresit të rajonit në rrugëtimin evropian". Kështu është thënë në një deklaratë të përbashkët të ShBA-së dhe të BE-së, të publikuar më 20 tetor. Deklarata është publikuar një ditë pasi Komisioni Evropian ka miratuar paketën e zgjerimit dhe raportet e progresit për vendet e rajonit të përfshira në këtë proces. "Ne nënvizojmë mbështetjen tonë të plotë për procesin e zgjerimit. Anëtarësimi në BE, prioriteti i deklaruar i tërë Ballkanit Perëndimor, ndihmon në konsolidimin e institucioneve demokratike, mbrojtjen e të drejtave themelore dhe avancimin e sundimit të ligjit. Ky rajon i takon Bashkimit Evropian. Integrimi më i afërt do ta forcojë stabilitetin dhe do të kontribuojë në prosperitetin e njerëzve në rajon. Në këtë kontekst, ne nënvizojmë se negociatat e anëtarësimit me Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut duhet të nisnin pa vonesa", është thënë në deklaratën e përbashkët. Në veçanti në këtë deklaratë përmenden edhe Kosova, Mali i Zi

dhe Bosnje e Hercegovina, vende ku ka pasur tensione në muajt e fundit.

BE-ja dhe ShBA-ja mbështetin veprimet e Kosovës në luftë kundër krimin të organizuar dhe inkurajojnë palët që të angazhohen për zbutjen e tensioneve Kosovë - Serbi. "Ne nënvizojmë rëndësinë e dialogut të lehtësuar nga BE-ja i cili është mekanizmi kyç për ta adresuar normalizimin gjithëpërfshirës të raporteve në mes të Serbisë dhe Kosovës. Pas tensioneve në javët e fundit në veri të Kosovës, ne inkurajojmë të dyja palët që të angazhohen për shtensionim të qëndrueshëm dhe t'i evitojnë veprimet të cilat kërcënojnë stabilitetin", është thënë në deklaratë. "Ne mirëpresim dhe mbështesim angazhimin e Kosovës në luftë kundër krimin të organizuar dhe korrupsionit dhe ritheksojmë se dhuna ndaj civilëve, gazetarëve, policisë, apo ndonjë autoriteti tjetër, është e papranueshme".

Deklarata e përbashkët ka ardhur disa ditë pasi përfaqësuesi i lartë i Bashkimit Evropian për Çështje të Jashtme dhe Siguri, Josep Borrell, e ka konsideruar të njëanshëm aksionin e Policisë së Kosovës për luftim të kontrabandës në disa qytete të Kosovës, përfshirë veriun.

Sa i përket Bosnje-Hercegovinës,



Shtetet e Bashkuara dhe Bashkimi Evropian përsëritin mbështetjen e plotë për integritetin territorial sikur edhe përpjekjet për t'i promovuar reformat kushtetuese dhe zgjedhore dhe ruajtjen e funksionalitetit të institucioneve shtetërore. "Jemi seriozisht të shqetësuar për shkak të rritjes së retorikës përçarëse në Bosnje e Hercegovinë. U bëjmë thirrje të gjitha palëve që të respektojnë dhe mbrojnë institucionet shtetërore, ta rifillojnë dialogun konstruktiv dhe të ndërmarrin hapa për ta avancuar përparimin në rrugën e integritetit

evropiane, përfshirë edhe përmes reformave relevante. Bashkimi Evropian dhe Shtetet e Bashkuara mbeten të gatshme të ndihmojnë në këtë drejtim", është theksuar në deklaratë.

BE-ja dhe ShBA-ja u kanë bërë thirrje edhe të gjitha forcave politike në Mal të Zi që të punojnë së bashku për të mbajtur dhe forcuar orientimin strategjik, i cili reflekton dëshirën e popullit të Malit të Zi, që të bëjë reforma përmes të cilave shpresa për një të ardhme në BE të bëhet realitet. Kohën e fundit është rritur angazhimi i Shteteve të Bashkuara

në rajonin e Ballkanit Perëndimor. Në të njëjtën kohë, nga të dyja anët e Atlantikut janë shtuar edhe thirrjet që BE-ja dhe ShBA-ja të veprojnë së bashku në këtë rajon, në mënyrë që të zgjidhen problemet kryesore, që mund të kenë potencial për tensionime të reja.

Ditë më parë, përfaqësuesi i lartë i Bashkimit Evropian për Çështje të Jashtme dhe Siguri, Josep Borrell, ka zhvilluar një takim me sekretarin amerikan të Shtetit, Antony Blinken dhe, mes të tjerash, kanë diskutuar edhe për Ballkanin Perëndimor.

BE-ja: Të enjten takohet grupi punues për targat

PRISHTINË, 20 TETOR - Bashkimi Evropian ka konfirmuar se të enjten, më 21 tetor, do të zhvillohet takimi i parë i grupit punues për çështjen e targave të automjeteve midis Kosovës dhe Serbisë. "Takimi i parë i grupit punues për targat e veturave me ekspertët nga të dyja palët do të zhvillohet më 21 tetor. Grupi punues ka për qëllim që të gjejë një zgjidhje të përhershme për këtë çështje", tha në një përgjigje për "Radion Evropë e Lirë", zëdhënësi i BE-së, Peter Stano. Stano shtoi se grupi punues i ekspertëve pritet të takohet rregullisht.

Më 20 shtator Qeveria e Kosovës vendosi masën e reciprocitetit për targat nga Serbia. Ky vendim u pasua me protesta dhe ngritje barrikadash në afërsi të dy pikëkalimeve kufitare që lidhin Kosovën me Serbinë: Jarinjë dhe Bërnjak.

Më 30 shtator, me ndërmjetësimin e Bashkimit Evropian, palët arritën një

zgjidhje të përkohshme dhe të dyja shtetet më 4 tetor nisën vendosjen e letrave ngjitëse në simbolet shtetërore në targa.

Sipas kësaj marrëveshjeje, Kosova dhe Serbia do të formojnë një grup punues, që brenda gjashtë muajsh të arrihet një zgjidhje e qëndrueshme për çështjen e lirisë së lëvizjes.

Ndërkaq Stano i tha "Radios Evropa e Lirë" se takimet e ekipeve negociuese dhe ato të nivelit të lartë do të zhvillohen në mënyrë të pavarur nga takimet e këtij grupi punues. Megjithatë, Stano tha se "nuk ka ende një datë" për takimet e negociatorëve apo takimeve në nivel të lartë në kuadër të dialogut të ndërmjetësuar nga BE-ja, porse po punojnë në atë drejtim.

Shefi i diplomacisë së BE-së, Josep Borrell, kishte biseduar me kryeministrin e Kosovës, Albin Kurti dhe me presidentin e Serbisë, Aleksandër Vuçiq, pas rritjes së tensioneve në veri të Kosovës dhe u kishte bërë



thirrje që sa më parë të kthehen në tryezën e dialogut. Tensionet në komunat në veri të Kosovës u rritën edhe pas një aksioni kundër kontrabandës të kryer nga Policia dhe Dogana e Kosovës më 13 tetor me ç'rast, si pasojë e protestave dhe barrikadave

në Mitrovicë të Veriut dhe Zveçan, u lënduan dhjetëra protestues dhe policë.

Edhe Komisioni Evropian, përmes Raportit të Progresit, të publikuar më 19 tetor, ftoi Kosovën dhe Serbinë që të kenë një angazhim konstruktiv në dialog dhe që urgjentisht të

arrihet një marrëveshje gjithëpërfshirëse, ligjrisht obliguese për normalizimin e raporteve.

Dialogu për normalizimin e raporteve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, nën ndërmjetësimin e BE-së, ka nisur më 2011.



SHEFI I ZYRËS SË BASHKIMIT EVROPIAN NË PRISHTINË, TOMAS SZUNYOG, UA KA DORËZUAR PËRFAQËSUESVE TË INSTITUCIONEVE TË KOSOVËS RAPORTIN E PËRPARIMIT TË PËRPILUAR NGA KOMISIONI EVROPIAN

Kosova zotohet se do t'i realizojë prioritetet e dala nga raporti i progresit

Shefi i Zyrës i Bashkimit Evropian në Kosovë, Tomas Szunyog, ka takuar ndaras presidenten e Kosovës, Vjosa Osmani, kryeparlamentarin Glauk Konjufca dhe kryeministrin Albin Kurti, të cilëve ua ka dorëzuar raportin e Komisionit Evropian për Kosovën. Ata janë zotuar se do t'i realizojnë prioritetet e dala nga raporti i progresit. Ndërkaq presidentja Osmani ka kërkuar sqarime nga shefi i BE-së në Prishtinë për moskonsultimin e institucionit të Presidencës në fazën para hartimit të raportit, siç janë konsultuar të gjitha institucionet e tjera dhe shoqëria civile

**EPOKA
ERE****Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 20 TETOR - Shefi i Zyrës i Bashkimit Evropian në Kosovë, Tomas Szunyog, ka takuar ndaras presidenten e Kosovës, Vjosa Osmani, kryeparlamentarin Glauk Konjufca dhe kryeministrin Albin Kurti, të cilëve ua ka dorëzuar raportin e Komisionit Evropian për Kosovën.

Presidentja Osmani ka nënvizuar se Republika e Kosovës e ka prioritet anëtarësimin në Bashkimin Evropian. Në këtë kontekst, ajo ka theksuar se asgjë dhe askush nuk do të mund ta ndalë vendosmërinë e institucioneve të reja të Republikës së Kosovës për sundim të ligjit dhe për ta mbrojtur integritetin e institucioneve.

Presidentja Osmani gjatë takimit me Szunyog ka potencuar se në kuadër të kompetencave kushtetuese do të jetë garantuese e realizimit të këtyre prioritetëve ashtu siç ka qenë edhe deri më tash. Ajo ka kërkuar sqarime për moskonsultimin e institucionit të Presidencës në fazën para hartimit të raportit, siç janë konsultuar të gjitha institucionet e tjera dhe shoqëria civile.

Osmani ka potencuar rëndësinë që raporti i ardhshëm të jetë gjithëpërfshirës dhe të reflektojë kontributin e Presidencës për arritjet gjatë periudhës raportuese.

Presidentja Osmani ka vlerësuar se angazhimi në rritje i institucioneve të Kosovës për zbatimin e reformave evropiane duhet të përcillet me diskutime me institucionet dhe shtetet anëtare të BE-së për fillimin e

procesit të negociatave për anëtarësim në BE.

Ajo ka theksuar se njohja e pavarësisë së Kosovës nga pesë shtetet anëtare të BE-së është veprim jo vetëm i drejtë, por do të shërbejë si shtysë për realizimin e reformave të brendshme dhe do t'i kontribuojë paqes dhe stabilitetit në rajon.

Presidentja Osmani ka mirëpritur rikonfirmimin e mbështetjes së Komisionit Evropian për liberalizimin e vizave për qytetarët e Kosovës si reflektim i përbushjes së të gjitha kërkesave që burojnë nga procesi formal i vlerësimit të veprimeve të institucioneve të Kosovës.

Ajo ka shtuar se liberalizimi i vizave është qenësor për ruajtjen e kredibilitetit të BE-së në raport me zbatimin efektiv të politikës së zgjerimit të bazuar në meritat dhe rezultatet e

angazhimeve të shteteve kandidatë.

Edhe kryetari i Kuvendit të Kosovës, Glauk Konjufca, së bashku me shefin e kabinetit, Ilir Kërçeli dhe këshilltaren Arbenita Mjekiçi, ka pritur në takim shefin e zyrës së BE-së në Kosovë, Tomas Szunyog, nga i cili ka pranuar raportin e Komisionit Evropian për Kosovën dhe Pakon e Zgjerimit të Bashkimit Evropian 2021. Konjufca ka vlerësuar bashkëpunimin dypalësh dhe kontributin e Bashkimit Evropian për perspektivën evropiane të Kosovës. Ai, po ashtu, nënvizoi progresin e theksuar në implementimin e reformave që kontribuojnë në procesin integruar të Kosovës në BE, duke veçuar me këtë rast si shembull për demokracinë në rajon e më gjerë mbajtjen e dy palë zgjedhjeve të lira e demokratike brenda këtij viti.

Ndërkaq shefi i zyrës së BE-së, ambasadori Szunyog, ka shprehur mirënjohje për frymën bashkëpunuese dhe ka rikonfirmuar gatishmërinë për shtimin e bashkëpunimit në drejtim të avancimit të legjislacionit, sundimit të ligjit dhe shtyrjes përpara të agjendës së përbashkët evropiane.

Raporti i Komisionit Evropian për Kosovën, i njohur më herët si raporti i progresit, i është dorëzuar edhe kryeministrit Albin Kurti. Ky i fundit ka thënë se rruga drejt integritetit në Bashkimin Evropian kërkon reforma dhe arritje të mëdha. "Në këta muaj qeverisë ne kemi dëshmuar se jemi në rrugën dhe drejtimin e duhur", ka deklaruar kryeministri Kurti.

Ai ka theksuar se në këtë rrugëtim do të ecim së bashku në partneritet dhe me mbështetjen e plotë të Bashkimit Evropian. "Në frymën e përkushtimit të fuqishëm të Kosovës ndaj rrugës së saj drejt BE-së, përmes Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit dhe Agjendës për Reforma Evropiane si korniza kryesore themelore, qeveria e re ka demonstruar një dinamikë të re të reformave përgjatë gjashtë muajve nga formimi i saj. Kjo dinamikë mund të shihet në reformat të cilat janë indikacion i një baze të fortë të potencialit të Kosovës në zhvillimin e shpejtë të saj në rrugën drejt Bashkimit Evropian", ka thënë kryeministri Kurti.

Në rrjedhën e sqarimit të ambasadorit Szunyog rreth raportit njëvjeçar, nga tetori 2020

deri në tetor 2021, kryeministri vuri theksin në pjesën e dytë të tij, në progresin e shënuar në gjashtë muajt e qeverisë së re. “Në këta gjashtë muajt të qeverisë kemi stabilitet institucional, legjitimitet demokratik dhe besueshmëri të lartë në institucione nga ana e qytetarëve që përbënë progres të madh shoqëror”, ka deklaruar Kurti. Kryeministri ka potencuar progresin dhe rezultatet konkrete në fushën e sundimit të ligjit, luftimit të krimit të organizuar dhe korrupsionit, administratës publike, zhvillimit ekonomik, punësimit dhe kujdesit social. Ai ka veçuar progresin e pamohueshëm në fushën e vaksinimit dhe menaxhimit të pandemisë. Duke biseduar për zgjedhjet komunale ku subjektet politike dhe kandidatët garuan me platformat e tyre, në takim u vlerësua se Kosova dëshmoi organizim dhe administrim të mirë, me transparencë të plotë dhe garë demokratike. Pas takimit, Kurti dhe Szunyog kanë mbajtur një konferencë të përbashkët për media. Kosova duhet të angazhohet në mënyrë konstruktive dhe të bëjë përpjekje të tjera substanciale për “zbatimin e të gjitha

marrëveshjeve të kaluara” të arritura në kuadër të dialogut me Serbinë dhe të “kontribuojë në arritjen e një marrëveshjeje gjithëpërfshirëse, ligjërisht të obligueshme për normalizimin e marrëdhënieve me Serbinë”, ka theksuar Komisioni Evropian në raportin e progresit. Sipas KE-së, një marrëveshje e tillë është urgjente dhe thelbësore në mënyrë që Kosova dhe Serbia të mund të përparojnë në rrugën e tyre drejt BE-së. Raporti ka theksuar se jostabiliteti politik dhe pandemia ndikuan në përparimin sa i përket zbatimit të agjendës së reformave evropiane të Kosovës që, sipas dokumentit, ka qenë i kufizuar. Prandaj Komisioni Evropian u bënë thirrje institucioneve të Kosovës që t'i qasen me prioritet zbatimit të agjendës evropiane. Raporti i progresit për Kosovën thekson jostabilitetin politik në Kosovë. Aty përmendën edhe zgjedhjet parlamentare të shkurtit dhe formimi i Qeverisë së Kosovës në muajin mars, por theksohet se në pjesën më të madhe të periudhës që përfshin ky raport, ka pasur një “atmosferë polarizuese politike”. KE-ja, po ashtu, vë theksin te situata në veri të Kosovës sa i

përket korrupsionit, krimit të organizuar dhe kushteve për lirinë e shprehjes dhe thuhet se situata në këtë pjesë është ende sfiduese. Bashkimi Evropian thotë se Kosova ka disa nivele të përgatitjes në luftën kundër korrupsionit, por që janë në fazë të hershme. “Gjatë periudhës së raportimit është bërë përparim i kufizuar, përfshirë edhe hetimet dhe gjykimi i rasteve të nivelit të lartë”, thekson KE-ja. Po ashtu, në luftën kundër krimit të organizuar thuhet se është bërë përparim i kufizuar. Komisioni Evropian, megjithatë, tha se Kosova ka bërë përparim në luftën kundër terrorizmit, “veçanërisht për rehabilitimin dhe riintegrimin e luftëtarëve të huaj dhe familjeve të tyre”. Megjithatë, Komisioni Evropian ka kritika për sistemin gjyqësor, pasi administrimi i drejtësisë vlerësohet se vazhdon të jetë “i ngadalshëm, joefikas dhe i ndjeshëm ndaj ndikimeve politike”. Si pikë pozitive është parë Strategjia për Sundimin e Ligjit dhe Planin e Veprimit që u miratua në gusht të vitit 2021. Por, synimet e Kosovës për të bërë veting në gjyqësor vetëm një herë janë parë me “shqetësim” nga KE-ja.



Sa është i sigurt ushqimi në Kosovë?

PRISHTINË, 20 TETOR - Sallatë lakre e domatesh, mish i kuq e i bardhë, ishin disa prej ushqimeve që dhjetëra persona në fshatin Trudë të Prishtinës kishin konsumuar në një mbledhje familjare. Pas konsumimit të ushqimit të porositur në një lokal në Prishtinë më 3 shtator 2021, shumë prej këtyre personave kishin kërkuar ndihmë mjekësore. Simptomat e të sëmurëve ishin kryesisht diarreja e të vjella. Pas testeve ishte konstatuar se ky rast kishte të bënte me helmim nga ushqimi. Dy ditë pas kësaj ngjarjeje, Policia e Kosovës ka alarmuar Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë (AUV) që dolën për ta inspektuar lokalin. AUV ka treguar për “Radion Evropa e Lirë” se fillimisht në lokal ishin inspektuar kushtet e përgjithshme sanitare që ishin vlerësuar në nivel mesatar. “Por, kishte mundësi të kontaminimit të kryqëzuar, pasi që në të njëjtën hapësirë ruhen produktet e gatshme për konsum me produktet lëndë e parë. Djathi, sosat ishin shumë afër vezëve, pa asnjë ndarje fizike, gjë që paraqet mundësi për kontaminim”, ishte konstatimi i inspektorëve. Sipas rezultateve të inspektimit, majonezi ishte gjetur se mbahej në temperaturë dhome e jo në

temperaturën e caktuar për ruajtje. Menjëherë pas kësaj, sipas AUV, lokali u mbyll përkohësisht për të vazhduar me analiza të tjera të ushqimit dhe kuzhinës. Strishot e marra në ambientet e kuzhinës treguan prani të bakterit Escherichia Coli që mund të shkaktojë helmim, ndërkaq në ushqimet si sallatat, mishrat dhe gjellët u gjetën baktere të gjalla mezofile dhe koliforme. Lokali u rihap pas inspektimit të dytë dhe vlerësimit se kushtet ishin përmirësuar. Megjithatë, ndaj këtij biznesi, sipas AUV, është iniciuar fletëparaqitja për gjykatë për kundërvajtje. Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë me inspektorët sanitarë nëpër komuna është institucioni i vetëm përgjegjës për inspektimet lidhur me sigurinë e ushqimit në Kosovë. Sipas AUV, ata hartojnë çdo vit plane për kontrolle zyrtare lidhur me sigurinë e ushqimit. “Këtij plani për çdo vit iu shtohen parametra të rinj krahasimisht me progresin për hartimin e akteve të reja, praninë së rreziqeve si dhe koncepteve të vendosura nga institucionet e BE-së”, thuhet në përgjigjen e Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë. Sipas kontrolleve në tri vjetët e fundit u iniciuan 169 raste të



kundërvajtjeve, përkatësisht shkelje të rregullave të sigurisë ushqimore. Sipas AUV, 30 raste ishin iniciuar më 2018, 85 raste më 2019 dhe në vitin 2020 u iniciuan 54 raste. Gjykata e Prishtinës ndërkohë nuk ka ofruar të dhëna se sa prej këtyre rasteve i kanë pranuar dhe çfarë është epilogu i tyre. Të dhëna nuk janë ofruar edhe lidhur me atë se sa aktakuza për çështje që kanë të bëjnë me sigurinë ushqimore janë duke u trajtuar në këtë gjykatë. Një raport i veçantë lidhur me sigurinë e ushqimit në Kosovë ishte bërë nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm në vitin 2019. Sipas këtij raporti, ka pasur

mungesa në koordinimin e kontrolleve nga inspektorët e nivelit komunal dhe atij qendror si dhe nuk është siguruar se kontrolli po bëhet në të gjitha fazat e përpunimit të ushqimit. Një shqetësim brenda këtij raporti është ngritur lidhur me funksionimin e tregjeve të palicencuara në komuna dhe sidomos ato të kafshëve ku edhe bëhet therja e pakontrolluar dhe shitja e mishit të pasigurt. Sipas raportit të Zyrës Kombëtare të Auditimit, vetëm gjatë vitit 2018 janë asgjësuar rreth 150 mijë kilogramë ushqime të ndryshme nga AUV-ja. Një rritje e numrit të inspektimeve lidhur me sigurinë

ushqimore, por edhe forcimi i zinxhirit të kontrollit është i domosdoshëm, sipas Selatin Kaçanikut, drejtor i organizatës “Konsumatori”. “Jo çdo artikull kalon nën kontrollin e agjencisë. Se ka produkte që nuk kontrollohen, është e ditur. Shumë të tilla dalin në treg, markete, gastronomi”, thotë ai për Radion Evropa e Lirë. Sipas tij, duhet të minimizohen mundësitë që ushqimi i pasigurt të mund të hyjë në vend për të evituar pastaj shpërndarjen nëpër treg të Kosovës. Këto kontrolle, sipas Kaçanikut, duhet të jenë shumë strikte sidomos për produktet e mishit, qumështit dhe miellit.

Reagim i KMDLNj-së

Lërimi fyerjet, bashkohuni për mbrojtjen e shtetit!

Kosova, nga shumë shtete, edhe ato që ia kanë njohur pavarësinë, po konsiderohet si rast i papërfunduar sa i përket integritetit territorial dhe shtrirjes së sovranitetit. Që nga fillimi i bisedimeve me Serbinë qartazi, nga "lehtësuesit" është deklaruar se çdo çështje do të diskutohet në tavolinën e bisedimeve dhe se nuk do të ketë asnjë temë tabu. Mbi këto baza, dhe e përkrahur fuqishëm nga disa fuqi të mëdha botërore dhe shtete evropiane Serbia, jo që nuk e ka pranuar pavarësinë e Kosovës, por se ka demonstruar pretendime të qarta ndaj integritetit territorial duke e vënë veriun e Kosovës 100 përqind nën kontroll sikur që ka instrumentalizuar serbët që kanë jetuar dhe jetojnë në brendi të Kosovës skajshmërisht duke përdorur "zonat e mbrojtura" nga Ahtisari dhe të tjerët. Në këtë kontekst është nënshkruar në Bruksel (në mesin e shumë marrëveshjeve) Marrëveshja për themelimin e Asociacionit të komunave serbe, ndonëse në Kosovë ishte dhe është një Asociacion i ligjshëm i komunave, pavarësisht përkatësisë etnike. Po i njëjti Asociacion ishte votuar në Kuvendin e Kosovës në vitin 2015 me 2/3 e votave të deputetëve të Kuvendit, aq sa është e nevojshme për ratifikimin e një Marrëveshjeje ndërkombëtare e që pastaj krijon raport obligativ për zbatim për faktin se në

Kushtetutën e Kosovës thuhet shprehimisht se: "një marrëveshje ndërkombëtare ratifikohet me votat e 2/3 të deputetëve të Kosovës...", pa e kushtëzuar (sikur në shumë vende të botës, si p.sh në Shqipëri) se: "një Marrëveshje ndërkombëtare nuk mund të ratifikohet në Kuvend pa pëlqimin e Gjykatës Kushtetuese...". Tash, ato 23 shkeljet që i ka evidentuar Kushtetua e Kosovës në Marrëveshjen e Asociacionit të komunave serbe janë të papërfillshme dhe shërbejnë vetëm për arsyetim dhe larje duarsh (si Pont Pilati), për nënshkruarit, përkrahësit dhe votuesit e kësaj marrëveshjeje. Serbia, që është kreu i pritshme sikur edhe bashkësia ndërkombëtare po këmbëngulë që të respektohet dhe zbatohet Marrëveshja burimore ndërsa vendimet dhe rekomandimet e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës e përmendin vetëm për të treguar se edhe Kosova paska Gjykatë Kushtetuese duke përdorur standarde të dyfishta: vendimet e Gjykatës Kushtetuese janë të pavlefshme kur bëhet fjalë për Asociacionin e komunave serbe ndërsa janë të vlefshme dhe duhet të zbatohen në rastin e Manastirit të Deçanit ku, nën presion politik dhe në mënyrë të kundërligjshme tjetërsohen 24 hektarë tokë, pronë publike, sipas ligjeve



diskriminuese të Serbisë. Qeveria e Kosovës sot dhe vet Kosova është vënë para një presioni, kërcënimi dhe shantazhimi të fuqishëm për zbatim të kësaj Marrëveshjeje; Lista Serbe dhe Goran Rakiq janë kërcënuar, bashkë me Vuçiqin dhe Petkoviqin se nëse Asociacioni nuk themelohet në muajin nëntor, të gjithë serbët do të largohen nga të gjitha institucionet e Kosovës. Në anën tjetër, Raporti i Progresit kërkon që urgjentisht të themelohet Asociacioni dhe se Marrëveshja finale gjithëpërfshirëse është çështja e ngutshme. Kur kësaj i shtohet konfiksioni i ri diplomatik në Ballkan atëherë bëhet e qartë se bisedimet me Serbinë janë afër përfundimit dhe se Marrëveshja finale thuaja është gatuar. KMDLNj i sheh të panevojshme dhe të tepërta përplasjet midis

liderëve politikë sikur edhe marrja, deri në ekzaltim me rezultatet e zgjedhjeve lokale në kohën kur për Kosovën pritet të merret një vendim, siç thonë vendimmarësit ndërkombëtarë i dhimbshëm për Kosovën. KMDLNj vlerëson se opozita aktuale ka përgjegjësi konkrete dhe faktike për marrëveshjen për formimin e Asociacionit të komunave serbe si dhe për ratifikimin e kësaj marrëveshjeje andaj nuk ka kredit moral dhe politikë të luftojë pozitën (Qeverinë aktuale) me këto armë. KMDLNj kërkon nga kryeministri i Kosovës, Albin Kurti të angazhohet seriozisht dhe konkretisht për ndërtimin e një konsensusi politikë dhe nacional pas së cilës do të nënshkruhet një marrëveshje eventuale me Serbinë. Në formën e sidomos në përmbajtjen që e ka Asociacioni i

ratifikuar duhet të diskutohet vetëm nëse garantohet pacenueshmëria e kufijve të jashtëm të Kosovës përmes njohjes reciproke si dhe duke njohur dhe pranuar kufijtë aktualë. Nuk ka dhe nuk mund të ketë nënshkrim të Marrëveshjes detyruese me Serbinë pa konsensus politik dhe nacional. Subjektet politike kosovare dhe liderët politikë duhet ta ndërtojnë këtë unitet në mënyrë që Kosova të dëmtohet sa më pak. Nëse Serbia dhe Lista Serbe po e shantazhojnë Kosovën në mënyrë agresive dhe të dhunshme për formimin e Asociacionit të komunave serbe edhe BE po e shantazhon Kosovën në mënyrë të sofistikuar përmes raporteve dhe pengimit të shtrirjes së sovranitetit në pjesën Veriore të Kosovës.

Sulmet ping-pong midis pozitës dhe opozitës vetëm sa po e dëmton pozicionin e Kosovës duke i krijuar të gjitha kushtet për një marrëveshje të keqe. Prandaj, duhet të kuptojnë se përgjegjësia për demin eventual, shumë të mundshëm për Kosovën nuk do të mund të individualizohet përgjegjësia por do të jetë e të gjithëve. Në këto kohëra transparenca për bisedimet dhe proceset është jetike dhe paraqet kusht për mbijetesën dhe ekzistencën e Kosovës dhe kjo, për fat të keq po mungon!

Kurti: Pabarazitë, padrejtësitë e paragjykimet duhet t'i luftojmë bashkë



PRISHTINË, 20 TETOR (ER) - "Ne nuk kemi jetë grash e vajzash për të humbur. Pabarazitë, padrejtësitë e paragjykimet duhet t'i luftojmë bashkë, prandaj na nevojitet angazhim maksimal, bashkim i forcave të organeve shtetërore dhe

prioritizim i rasteve të dhunës në familje, ashtu që të kemi rezultat të suksesshëm", ka deklaruar kryeministri Albin Kurti në takim konsultativ me temën "Përgjigjet institucionale ndaj dhunës kundër grave në periudhën (post) Covid-19".

Ai ka thënë se mungesa në drejtësi dhe barazi i nxit normat sfiduese dominuese e patriarkale dhe padrejtësia shtesë nga mosveprimi i shtetit në rolin e tij si mbrojtës, e bën më të ashpër e të dukshme këtë. "Kjo ngufatje po na dërgon deri

te mohimi i së drejtës për jetë të grave dhe vajzave tona në Kosovë. Përbrendësimi i kësaj situatë kërkon jo heshtje, por veprim, jo fshehje të së vërtetës, por ndërhyrje në thelbin dhe rrënjën e gjërave", ka thënë kryeministri Kurti.

Ai ka falënderuar të gjithë që ofrojnë mbrojtje dhe mbështetje për gratë dhe vajzat, kudo dhe kurdo që ato kanë nevojë për ndihmë. "Jeta e dinjitetshme dhe e drejta për ta gëzuar atë janë të drejta të garantuar me Kushtetutë dhe ligj, dhe asnjëri nuk mund ta mohojë këtë gjë. Çdo tentativë e mohimit të saj, është jo veç se e ndaluar, por edhe e dënueshme", është shprehur ai, duke theksuar se detyra e shoqërisë, e veçanërisht qeverisë, është që të garantojnë një ambient të sigurt e të jetueshëm, pa drojë e pa frikë. Organizuar nga Agjencia për Barazi Gjinore në kuadër të Zyrës së Kryeministrit në bashkëpunim me Qendrën Kosovare për Studime Gjinore, në takim konsultativ u bisedua për koordinimin ndërsektorialë në luftimin e dhunës ndaj grave dhe vajzave në Kosovë, gjatë dhe pas pandemisë Covid-19.

Bie numri i pacientëve me Covid të shtrirë në spitalet e Kosovës

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 20 TETOR - Në Kosovë u raportuan të mërkurën 14 raste të reja me Covid-19, ka njoftuar Ministria e Shëndetësisë. Sipas raportit të saj ditor, rastet e reja rezultuan pas testimit të 2 140 mostrave.

Në 24-orëshin paraprak nuk u raportua për asnjë viktimë, ndërsa si të shëruar u konfirmuan 61 pacientë.

Aktualisht numri i rasteve aktive me Covid është 515.

Që nga fillimi i pandemisë Kosova ka regjistruar mbi 160 000 raste të të infektuarve dhe 2 974 viktima. Deri të mërkurën, mbi 681 000 qytetarë të Kosovës janë vaksinuar plotësisht kundër koronavirusit.

Ndërkaq Shërbimi Spitalor Klinik dhe Universitar i Kosovës ka njoftuar se 59 pacientë nga Covid-

19 po trajtohen në kuadër të ShSKUK-së, prej tyre 29 me oksigjeno-terapi dhe dy në kuadër të mjekimit intensiv.

Ministria e Shëndetësisë ka bërë me dije para dy ditësh se deri më tani në Kosovë janë administruar 1.5 milion vaksina kundër Covid-19.

Kjo ministri ka theksuar se derisa përballimi me variantin shumë ngjites 'Delta' të Covid-19, ndryshimi nuk do të vijë nëse nuk punojmë të gjithë së bashku për t'u vaksinuar.

Ministria e Shëndetësisë ka njoftuar se vaksinimi është mbrojtja më e mirë që kemi: "Asgjë nuk ka mbaruar ende. Vaksinat e sigurta dhe efektive kundër Covid-19 janë në dispozicionin tuaj".

Kurse Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës ka theksuar përmes një njoftimi se situata epidemiologjike me Covid



vazhdon me rënie të numrit të rasteve të reja pozitive dhe numrit të vdekjeve por, megjithatë, situata është ende jostabile duke pasur parasysh se varianti 'Delta' është i pranishëm dhe është varianti dominues në qarkullim në Kosovë.

"IKShPK-ja apelon te të gjithë qytetarët për respektimin e të gjitha masave sipas vendimeve të Qeverisë së Republikës së Kosovës. Për shkak të rrezikshmërisë së lartë të përhapjes së Covid-19, bëjmë thirrje për kujdes dhe

mosgrumbullim. Rekomandojmë institucionet përgjegjëse të mbikëqyrin me përpikëri dhe të ndërmarrin të gjitha veprimet e nevojshme për parandalimin dhe luftimin e pandemisë", është thënë në mesazhin e IKShPK-së.

Policia pengon një rast të kontrabandës me mallra në kufi me Serbinë

EPOKA
ERE

Qendresa RAMA

RANILLUG, 20 TETOR - Policia e Kosovës ka njoftuar se ka penguar një rast të kontrabandës me mallra nga Serbia në Kosovë. Përmes një komunikate për media, Policia ka thënë se në fshatin Domorocv, të komunës së Ranillugut, është futur një traktor që dyshohej se kishte mallra kontrabandë.

Zyrtarët policorë është thënë të

kenë identifikuar lokacionin ku është ndalur traktori dhe në të kanë gjetur pako me ilaçe të llojeve të ndryshme, si dhe pajisje të instalimit elektrik. Me urdhër të Prokurorisë Themelore në Gjilan, traktori me mallra është sekuestruar dhe është iniciuar rasti "kontrabandë me mallra". Zyrtarët policorë është thënë se janë duke tentuar t'i identifikojnë të dyshuarit.

Ditë më parë Policia e Kosovës ka kryer një aksion për luftim të

kontrabandës me mallra në disa qytete të Kosovës, përfshirë veriun. Në Mitrovicë të Veriut dhe Zveçan aksioni nuk ka përfunduar pasi zyrtarë policorë janë penguar gjatë punës.

Policia ka thënë se në këtë aksion janë sekuestruar mallra "të kontrabanduara në vlerë prej qindra mijëra eurosh të cilat shërbejnë si prova materiale, të cilat kanë qenë të vendosura në lokacione të ndryshme, lokale afariste, magazina/depo etj".

EPOKA
ERE

QENDRESA RAMA

PRISHTINË, 20 TETOR (ER) - Presidentja e Republikës së Kosovës, Vjosa Osmani, ka pritur të mërkurën në takim komandantin e ri të KFOR-it, gjeneralmajor Ferenc Kajari, të cilin e ka urrear për detyrën, duke e vlerësuar kontributin e forcës

Osmani e pret në takim komandantin e ri të KFOR-it

shumëkombëshe në sigurimin e një ambienti të qetë e të sigurt në Kosovë. Duke e përmendur rolin e KFOR-it që prej vitit 1999, presidentja Osmani ka theksuar se ky mision paqeruajtës ka kontribuar jo vetëm në aspektin e sigurisë, por edhe në projekte të ndryshme infrastrukturore, sikurse edhe në fushën e shëndetësisë në përballje me

pandeminë. Më tej, presidentja Osmani ka përmendur bashkëpunimin në nivel të KFOR-it me FSK-në, duke ritheksuar synimin e Kosovës për anëtarësim në NATO. Ndërkaq gjeneralmajor Kajari ka shfaqur gatishmërinë për vazhdimin e bashkëpunimit dhe konsultimeve të rregullta në kuadër të mandatit që ka KFOR-i në Kosovë.

Kryetari i Rinisë së PDK-së nderohet me çmimin IRI Freedom Award

PRISHTINË, 20 TETOR (ER) - Kryetari i Rinisë Demokratike të Kosovës, Donjet Bislimi, është nderuar me çmimin IRI Freedom Award, në emër të organizatës EDYN nga senatorja Joni Ernst nga Republika e Iowas, për kontributin e tij dhënë gjatë periudhës së pandemisë në Kosovë si doktor vullnetar dhe si

asamblist në komunën e Mitrovicës për ndërmarrjen iniciativave për t'u dalë në ndihmë qytetarëve. Këtë çmim, që ndahet nga viti 1995 për personalitetet që kanë kontribuar për avancimin e lirisë dhe demokracisë, si dhe për përmirësimin e jetës së njerëzve në tërë botën, më parë e kanë

marrë edhe George Bush, Colin Powell, Ronald Reagan, Robert Dole dhe Hamid Karzai. EDYN, falë angazhimit dhe mbështetjes së Institutit Republikan - IRI, po e vendos Kosovën dhe të rinjtë e saj në hartën e shteteve kontributdhënëse për njerëzimin.



Ekonomia e Kosovës pritet të rritet në 9.9 për qind për vitin 2021

Guvernatori i Bankës Qendrore të Kosovës (BQK), Fehmi Mehmeti, ka thënë se aktiviteti ekonomik në vendin do të rikuperohet me një ritëm të shpejtë të rritjes prej 9.9-përqindësh për vitin 2021

EPOKA E RE

Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 20 TETOR - Komisioni për Buxhet, Punë dhe Transfere ka shqyrtuar të mërkurën raportin vjetor financiar të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës për vitin 2020 të cilin para deputetëve e ka paraqitur guvernatori i BQK-së, Fehmi Mehmeti.

Gjatë paraqitjes së raportit, Mehmeti ka thënë se gjatë vitit 2020, për shkak të pandemisë Covid-19, u paraqitën krizat më të mëdha ekonomike, ndërsa ka

vlërësuar se BQK-ja është treguar aktive duke reaguar shpejt, në mënyrë që të ruhet qëndrueshmëria financiare. "Sipas vlerësimeve ekonomia e Kosovës gjatë vitit 2020 ka shënuar rënie prej 5.3-përqindësh. Efekti i rënies së ekonomisë është manifestuar përmes sektorit të jashtëm. Ndalimi i udhëtimit ka bërë që të bie në mënyrë drastike numri i mërgimtarëve, si dhe eksporti i shërbimeve të udhëtimit, që në vitin 2020 zbriti në mbi 628 milionë euro, krahasuar me vlerën prej 1.3 miliard eurosh që ishte një vit më parë", ka thënë Mehmeti. Ai ka



theksuar edhe mungesën e bordit funksional të BQK-së nga viti 2020, prandaj e ka konsideruar të nevojshme kompletimin sa më të shpejtë të tij.

Guvernatori Mehmeti ka thënë se sa i përket vitit 2021, BQK-ja konsideron se aktiviteti ekonomik

do të rikuperohet me një ritëm të shpejtë të rritjes prej 9.9-përqindësh. Pas paraqitjes të raportit vjetor financiar për vitin 2020, u hap debati për pyetjet e anëtarëve të komisionit.

Anëtarët e komisionit u interesuan kryesisht për çmimin e sigurimit të

veturave, punësimet në BQK, si dhe shumë çështje të tjera.

Guvernatori Mehmeti dhe përfaqësuesit e tjerë të BQK-së që ishin të pranishëm u përgjigjën në pyetjet e anëtarëve të komisionit. Pasi që kishte edhe pyetje të tjera, kryetari Armend Muja ka propozuar që shqyrtimi i raportit vjetor financiar të BQK-së për vitin 2020 të vazhdojë në mbledhjen e ardhshme, propozim ky që u përkrah nga anëtarët e komisionit. Për në mbledhjen e ardhshme u shty edhe shqyrtimi i raportit vjetor të Fondit të Kursimeve Pensionale për vitin 2020 dhe shqyrtimi i raportit vjetor financiar të qeverisë për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2020 si dhe votimi i raportit vjetor financiar të Agjencisë për Krahasim dhe Verifikim të Pronës për vitin 2020 i cili ishte shqyrtuar në mbledhjen e kaluar.

Kurti viziton "Trepçën", rikonfirmon përkrahjen për ndërmarrjen dhe për menaxhmentin

**EPOKA E RE**

Albulena S. MAVRAJ

MITROVICË, 20 TETOR - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, së bashku me ministren e Ekonomisë, Artane Rizvanolli, me zëvendësministrin e Ekonomisë, Mentor Arifajn dhe me shefin e Njësisë për Monitorimin e Ndërmarrjeve Publike, Besim Imeri, si edhe me dy deputetët e Kuvendit të Kosovës, Armend Muja dhe Arjeta Fejza, kanë

vizituar të mërkurën ndërmarrjen "Trepça".

Në takim me udhëheqjen e "Trepçës", kryesuesin e Bordit, Bahri Hyseni dhe me ushtruesin e ri të detyrës së kryeshefit, Enis Abdurrahmani, biseduan për mbarëvajtjen e punëve në këtë ndërmarrje.

Kryeministri u shpreh i inkurajuar me faktin që në muajin shtator ka pasur prodhim shumë të madh në "Trepçë". "Jemi të lumtur që kur ishim në

qeverisje në pranverën e kaluar, e kemi dëshmuar tashmë edhe tek udhëheqja, edhe te punëtorët, se jemi shumë të interesuar për "Trepçën" dhe këtë e kemi bërë konkretisht e materialisht. Mbi shtatë milionë euro patëm ndarë për Trepçën - mbi 3.5 milionë për rimëkëmbje, në një rënë anë, dhe po aq për paga e investime kapitale", ka thënë ai.

Kurti ka ritheksuar se me projektin për Fondin Sovran ka vendosur në qendër të zhvillimit

të ardhshëm ekonomik "Trepçën".

Nga kryesuesi dhe ushtruesi i detyrës së kryeshefit kryeministri u njoftua edhe mbi zhvillimet dhe incidentin e fundit që ndodhi në "Trepçë". Kurti shprehi keqardhje për sulmin e organizuar dhe të dhunshëm mbi udhëheqjen dhe e dënoi ashpër këtë sulm, i cili, siç tha ai, është i drejtuar kundër "Trepçës" e Kosovës. "Si kryeministër i Republikës së Kosovës zotohem se nuk do të

ketë asnjë individ as grup më të fuqishëm se shteti. Ata të cilët si individë, ose grupe, synojnë ta dëshirojnë të jenë më të fuqishëm se shteti, ata bien ndesh me ligjin dhe kushtetutshmërinë të ne. Ne jemi republikë, jemi demokraci, jemi qeverisje e mirë, andaj ushtruesi i detyrës së kryeshefit është Enis Abdurrahmani dhe ai e ka mbështetur time të plotë bashkë me z. Bahri, që është kryesues i bordit këtu", ka deklaruar kryeministri Kurti.

Ish-ambasadori Greiçevci rikthehet në Hagë si pjesë e ekipit mbrojtës të Thaçit

Ish-ambasadori i Republikës së Kosovës në Hagë, Lirim Greiçevci, ka folur lidhur me shkarkimin e ambasadorëve, proceset gjyqësore në Hagë dhe dialogun me Serbinë.

Duke folur për Gjykatën Speciale, ai ka thënë se tashmë është bërë pjesë e ekipit mbrojtës të Hashim Thaçit, i cili gjendet në paraburgim në Hagë.

“Ashtu siç ishte përcaktuar në vendim për largimin nga misioni, unë e kam përmbyllur misionin tim diplomatik në Hagë më 30 gusht 2021, dhe jam kthyer në Kosovë. Mirëpo, tani jam rikthyer në Hagë si këshilltar në ekipin mbrojtës të Hashim Thaçit.

“Unë nuk e kam komentuar publikisht punën e Dhomave të Specializuara asnjëherë gjatë mandatit tim si ambasador i Kosovës në Hagë. Mendoj se zyrtarët shtetërorë duhet të përmbahen nga komentimi i vendimeve gjyqësore. Ndërsa aq më pak do ta komentoj tani që jam akredituar si pjesë e një ekipi mbrojtës. Por, mund ta them këtë gjë, në cilësinë e qytetarit të Kosovës: bashkëpunimi i Kosovës me drejtësinë ndërkombëtare është i pashembullt kudo në botë. Asnjë pjesëtar i UÇK-së, i cili është kërkuar nga drejtësia ndërkombëtare ose vendore, nuk iu ka shmangur asaj. Dhomat e Specializuara janë mekanizmi i katërt i ndërkombëtarëve për ta hetuar dhe gjykuar UÇK-në, një forcë vullnetare për çlirimin e Kosovës, aleate e NATO-s dhe e Perëndimit”, ka thënë Greiçevci në një intervistë për “Indeksonline”.

Intervista e plotë:

Z. Greiçevci, ju jeni ndër 12 ambasadorët e shkarkuar së fundi, si e keni përjetuar këtë vendim?

Greiçevci: Vendimet për emërimet dhe tërheqjet e diplomatëve, në këtë rast të ambasadorëve, janë e drejtë ligjore dhe kushtetuese e institucioneve përkatëse në Kosovë. Mirëpo, në sisteme demokratike, vendimet nuk merren në mënyrë grupore, arbitrare dhe për nevoja të ngushta politike të qeverisë aktuale. Emërimet e ambasadorëve direkt nga cilado qeveri aktuale janë të rregulluara me ligj. Askund nuk thuhet në ligj që një qeveri, ose president, kur e merr detyrën, mund të bëjë kësi largime stihike. Në ligj parashihen kushtet kur mund të bëhet tërheqja e

parakohshme. Ato janë injoruar në tërësi në rastin tonë, dhe tërheqjet nuk janë bërë në frymën e ligjit, duke dëmtuar kështu edhe raportet bilaterale me shtetet përkatëse.

Ambasadat janë të shtetit të Kosovës dhe jo të asnjë qeverie aktuale të Kosovës. Në këtë aspekt, ato hyjnë në rang me institucione shtetërore si ushtria, policia, inteligjenca dhe të ngjashme. Ato u shërbejnë të gjithë qytetarëve të Kosovës pa dallim: qeverisë aktuale, opozitës, shoqërisë civile, diasporës.

Tërheqja grupore e një numri kaq të madh të ambasadorëve, përnjëherësh, ka shkaktuar së paku dy precedentë të dëmshëm për të ardhmen: i ka hapur rrugë qeverive të ardhshme që të veprojnë në të njëjtën mënyrë, duke larguar të emëruarit politikisht të qeverisë pararendëse, në grup, si dhe do t’ua pamundësojnë njerëzve me profil të lartë që t’i pranojnë këto emërimet në të ardhmen, nga pasiguria e mosushtimit të mandatit të plotë. Sidoqoftë, shpresoj se këto praktika të këqia të vendosura nga pushteti aktual nuk do të përsëriten nga qeveritë e ardhshme.

Unë mund të flas për vetëveten, në të gjitha pozitat shtetërore që kam pasur, si këshilltar kryeministri, pjesë e ekipit negociator për Dialogun me Serbinë, dhe së fundi si ambasador në Holandë, Mbretëri të Bashkuar dhe Irlandë, asnjëherë nuk kam vepruar në interes të grupeve të ngushta, por në shërbim të të gjithë qytetarëve pa dallim. Në fakt, asnjëherë, askush, asnjë zyrtar shtetëror ose partiak, nuk ka kërkuar nga unë që të anoj në një anë ose tjetër. Jo që do të pranoja edhe po të kërkonte dikush, por dua ta bëj të qartë këtë gjë, dhe t’i falenderoj publikisht dy presidentë, katër kryeministra, pesë ministra të jashtëm, të partive të ndryshme politike, me të cilët kam punuar, që nuk kanë bërë asnjëherë kërkesa të tilla.

Është paralajmëruar nominimi i z. Dren Doli si ambasador i ardhshëm i Kosovës në Holandë? Çfarë mendimi keni për kandidimin e tij dhe çfarë sfida e presin atë në misionin e tij atje?

Greiçevci: Mendoj se është zgjedhje e mirë. Në fakt, unë jam takuar me z. Doli në Kosovë, për ta informuar lidhur me marrëdhëniet bilaterale Kosovë-Holandë dhe hollësi të tjera të funksionimit të misionit



diplomatik atje. Unë jam i interesuar që ai të ketë sukses dhe do të jem në dispozicion të tij për çdo këshillë, për t’ia lehtësuar ushtrimin e funksionit të tij. Sfidat kryesore do të jenë, natyrisht, avancimi i raporteve Kosovë-Holandë (në veçanti liberalizimi i vizave) dhe proceset gjyqësore në Dhomat e Specializuara të Kosovës në Hagë. Shpresoj se, pas përmbylljes së procedurave të nevojshme, ai do mund të dislokohet sa më parë në Hagë, në mënyrë që ambasada të ketë përfaqësim të duhur.

Ju keni përmbyllur misionin tuaj në Hagë më 30 gusht, çfarë jeni duke bërë aktualisht?

Greiçevci: Po, ashtu siç ishte përcaktuar në vendim për largimin nga misioni, unë e kam përmbyllur misionin tim diplomatik në Hagë më 30 gusht 2021, dhe jam kthyer në Kosovë. Mirëpo, tani jam rikthyer në Hagë si këshilltar në ekipin mbrojtës të z. Hashim Thaçit.

A mund të na jepni një koment tuajin lidhur me proceset gjyqësore në Dhomat e Specializuara në Hagë?

Greiçevci: Unë nuk e kam komentuar publikisht punën e Dhomave të Specializuara asnjëherë gjatë mandatit tim si ambasador i Kosovës në Hagë. Mendoj se zyrtarët shtetërorë duhet të përmbahen nga komentimi i vendimeve gjyqësore. Ndërsa, aq më pak do ta komentoj tani që jam akredituar si pjesë e një ekipi mbrojtës. Por, mund ta them këtë gjë, në cilësinë e qytetarit të Kosovës: bashkëpunimi i Kosovës me drejtësinë ndërkombëtare është i pashembullt kudo në botë. Asnjë pjesëtar i UÇK-së, i cili është kërkuar nga drejtësia ndërkombëtare ose vendore,

nuk iu ka shmangur asaj. Dhomat e Specializuara janë mekanizmi i katërt i ndërkombëtarëve për ta hetuar dhe gjykuar UÇK-në, një forcë vullnetare për çlirimin e Kosovës, aleate e NATO-s dhe e Perëndimit.

Ndërkaq, Tribunali i Hagës për ish Jugosllavinë kishte akuzuar dhe gjykuar gjashtë pjesëtarë të UÇK-së, prej tyre pesë qenë liruar të pafajshëm. Ky numër kaq i madh i të shpallurve të pafajshëm është tregues shqetësues për nivelin e dëshmimeve që janë përdorur për t’i akuzuar ata. Secili prej tyre ka humbur shumë vite të jetës në paraburgim në Hagë. Ndërsa UNMIK-u dhe EULEX-i kanë gjykuar me dhjetëra raste në Kosovë. Nëse i shtojmë edhe rastet e ish pjesëtarëve të UÇK-së të cilët i ka gjykuar Serbia, si dhe ato nga gjyqësori i Kosovës nga viti 2018, kur i mori për herë të parë kompetencat për krime lufte, atëherë i bie që gjashtë mekanizma të ndryshëm gjyqësorë, deri më tani, e kanë ndjekur dhe gjykuar UÇK-në. Kjo nga shumëkush në Kosovë dhe jashtë saj shihet si përndjekje, si terror gjyqësor, ndaj një struktureje vullnetare, vetëmbrojtëse, e cila kishte qëllim të vetëm ndalimin e dhunës serbe në Kosovë, njëjtë sikur edhe NATO.

Për dallim, janë vetëm katër serbë të cilët janë dënuar në Hagë për krimet e kryera në Kosovë. Ndërsa i pesti, ish presidenti serb, Millan Millutinoviç, ishte liruar si i pafajshëm nga akuzat për ndërmarrje të përbashkët kriminale, një president i një struktureje të organizuar shtetërore, që ka refuzuar marrëveshjen e paqes në Rambuje, që ka mundësuar gjenocidin mbi popullin e Kosovës, ka votuar për të hyrë në luftë me NATO-n si anëtar i

Këshillit të Lartë të Mbrojtjes, së bashku me Sllobodan Millosheviçin. Ai madje ishte lejuar ta përfundonte mandatin e tij si president i Serbisë dhe ishte dorëzuar në Hagë tek pas përfundimit të tij. Ndërsa, që të gjithë kriminelët tjerë serbë, të cilat kanë ekzekutuar planet gjenocidiale serbe në Kosovë, enden të lirë në Serbi. Ky kontrast, për ta ekzaminuar në mënyrë mikroskopike UÇK-në, palën e vetëmbrojtur, dhe për ta lënë të lirë palën agresore serbe, do të hyjë në histori si padrejtësia më e madhe në kohërat moderne.

Ju keni qenë pjesë e ekipit negociator të Kosovës kur pati filluar ai më 2011, a mund të na jepni një vlerësim për qasjen e Qeverisë Kurti lidhur me dialogun të ndërmjetësuar nga BE?

Greiçevci: Z. Kurti ka qenë në opozitë një kohë të gjatë, duke kundërshtuar çdo gjë, shpesh me mjete të dhunshme, dhe shihet qartë që nuk e ka as përvojën dhe as gatishmërinë për t’u përballur as me sfidat e qeverisjes, e lëre më me Dialogun me Serbinë. Mohimi i çdo përparimi të bërë gjatë dy dekadave të fundit dhe rritja artificiale e pritjeve të qytetarëve, mbart me vete rreziqe të zhgënjimeve të mëdha. Kjo edhe u pa në zgjedhjet e fundit lokale, ku partia në pushtet doli pothuajse e përgjysmuar.

Ndërkaq, lidhur me Dialogun me Serbinë, unë kam qenë pjesë e ekipit negociator të Kosovës më 2011, kur pati filluar Dialogu për herë të parë, dhe mund të them se të ulesh përballë palës serbe është një gjë shumë e pakëndshme. Janë njerëz që sillen si viktima, pas gjithë atyre luftërave dhe krimeve që kanë shkaktuar në ish Jugosllavi. z. Kurti e pret një sfidë, aspak e lehtë, por, përmbyllja e këtij Dialogu me njohje të ndërsjellë, është obligim i çdo kryeministri dhe qeverie të Kosovës. Prandaj, z. Kurti duhet të sillt përgjegjshëm dhe të jetë palë e angazhuar. Serbia, më shumë se çdo gjë tjetër, e lakmon ndërrimin e pozicioneve: që ajo të hiqet si palë konstruktive, që do rezultat, ndërsa Kosova jo. Kjo nuk guxon të ndodhë. Kosova është shtet i pavarur, është fitimtare e luftës me Serbinë, prandaj duhet të sillt si e tillë, me besim në vetëveten dhe në ndërmjetësimin e BE-së dhe mbështetjen e SHBA-së.



QENDRA SPORTIVE 'BUJQËSIA'
TEL: 045/82 82 82

Gjilani e zbret Drenicën nga fronti

Skuadra e Gjilanit ka arritur t'i marrë tri pikë të plota në ndeshjen ndaj Drenicës. Kjo e fundit, pas kësaj humbje, ka rënë në pozitën e dytë në elitë. Ballkani është ndalur nga Dukagjini në barazim, por një pikë i ka mjaftuar për ta marrë kryesimin

EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 20 TETOR - Skuadra e Gjilanit e ka mposhtur të mërkurën Drenicën (2-1) në derbin e javës së dhjetë në BKT Superligën e Kosovës në futboll. Pjesa e parë e ndeshjes përfundoi me rezultat 0-0. Në minutën e 64-t Gerhard Progni e shënoi golin e parë në ndeshje. I njëjti futbollist e dyfishoi epërsinë e Gjilanit me golin e shënuar nga penalltia dhjetë minuta pa përfunduar koha e rregullt.

Drenica u përpoq të rikthehet në lojë, por e tëra që arriti ishte goli i shënuar nga Zabergja. Pas kësaj humbjeje, Drenica bie në pozitën e dytë me 17 pikë, derisa

Gjilani është në pozitën e tretë me pikë të barabarta me kuqezinjtë nga Skenderaj. "Me të vërtetë më gëzon shumë kjo fitore. E kemi cilësuar si ndeshje të vështirë. Drenica ka qenë lidere me meritë deri tani. Ka luajtur futboll më të mirë sesa të gjithë. E patëm shumë të vështirë. I kemi pasur dy probleme kryesore. Skuadra ka arritur në atë nivel që e kemi komfort të luajmë si të duam. Ne po dimë t'i godasim kundërshtarët në kundërsulme. Kur e kemi një portier sikurse Koliçi, puna është shumë më e lehtë. Tash e tutje duhet të përmirësohemi duke luajtur mirë, duke luajtur futboll ofensivë të grumbullojmë sa më shumë pikë", ka thënë pas ndeshjes,



Ismet Munishi, trajner i Gjilanit. Në ndeshjen tjetër që u zhvillua të mërkurën në Klinë në mes të Dukagjinit dhe Ballkanit, fitues nuk pati për faktin se ndeshja u mbyllë me rezultat 0-0. Pavarësisht prej këtij barazimi,

Ballkani ngrehet në pozitën e parë me 18 pikë, kurse Dukagjini mbetet në vendin e tetë me 10 pikë. Në kuadër të javës së dhjetë, Prishtina të martën ka marrë tri pikë shumë të rëndësishme nga përballja me Malishevën (2-1).

Ndërsa Drita është këndellur dhe ka arritur t'i marrë tri pikë nga përballja me Feronikelin (0-2) në ndeshjen e javës së dhjetë që është zhvilluar në stadiumin "Rexhep Rexhepi" në Drenas. Fitore me rezultat më të thellë në këtë javë e regjistroi Llapi në përballje me Ulpianën (0-6).

SUPERLIGA - Java 10

Dukagjini - Ballkani	0-0
Gjilani - Drenica	2-1
Feronikeli - Drita	0-2
Ulpiana - Llapi	0-6
Prishtina - Malisheva	2-1

Tabela		Pikë
1. Ballkani	10	18
2. Drenica	10	17
3. Gjilani	10	17
4. Drita	10	16
5. Prishtina	10	13
6. Malisheva	10	12
7. Llapi	10	12
8. Dukagjini	10	10
9. Feronikeli	10	10
10. Ulpiana	10	7

Gliha: Do të jem trajner i Kosovës, kam arritur marrëveshje me FFK-në



PRISHTINË, 20 TETOR - Trajneri sloven Primoz Gliha mund të jetë përzgjedhës i ri i Kosovës në futboll. Lajmin e ka bërë me dije vetë Gliha, i cili ka thënë se ka arritur marrëveshje me Federatën e Futbollit të Kosovës. FFK-ja është duke kërkuar një zëvendësues për Bernard Challandës i cili u shkarkua pas

humbjes nga Gjeorgjia. "Është e vërtetë se unë jam pajtuar me drejtuesit e Federatës së Futbollit të Kosovës për ta udhëhequr ekipin kombëtar për dy ndeshjet e nëntorit dhe bashkëpunimi ynë i mëtejshëm është në duart e drejtuesve të Federatës së Kosovës, natyrisht", ka thënë Gliha. "I kam dëgjuar, po ashtu,

disa emra të njohur në publik të cilët janë kandidatë (për trajnerë të Kosovës), por unë i shoh këto si thashetheme të zakonshme në futboll në raste të kësilla", ka deklaruar Gliha. Disa emra të mëdhenj janë përmendur për stolin e Kosovës gjatë këtij muaji, përfshirë Felix Magath, Walter Zenga dhe Roberto Carlos.

Kiana Kryeziu synon ta fitojë normën olimpikë 'Pekini 2022'

Kiana Kryeziu është vetëm 16-vjeçare, por synon të hyjë në histori të sportit të Kosovës. Ajo mund të bëhet femra e parë që përfaqëson Kosovën në Lojërat Olimpikë Dimërore. Një gjë e tillë mund të ndodhë në muajin shkurt të vitit të ardhshëm, kur në kryeqytetin e Kinës mbahen Lojërat Olimpikë Dimërore "Pekini 2022". Për ta realizuar ëndrën, asaj i duhet të paktën një normë olimpikë në njërin nga pesë disiplinat e skijimit alpin. Ajo normën po e ndjek në disiplinat taktike, sllalom dhe sllalom të madh. "Në sezonin e kaluar e kam fituar një rezultat të nevojshëm në sllalom, kurse tani më duhen edhe katër të tillë. Besoj



se do t'ia dalë të fitoj normën", ka thënë Kryeziu për Komitetin Olimpik të Kosovës. Ajo kishte fituar medaljen e

argjendtë në disiplinën e sllalomit në garën e Kolashinit, të mbajtur në mars të këtij viti. Kiana ishte bërë skitarja e parë femër nga Kosova që

fiton medalje në një garë ndërkombëtare të organizuar nga Federata Ndërkombëtare e Skitarisë (FIS). "Synimi im është të bëhem femra e parë që fiton normën olimpikë për sportet dimërore në historinë e sportit tonë. Norma olimpikë është synimi im kryesor dhe për të jam duke punuar vazhdimisht", ka shtuar ajo. Garat për skitarët tanë nisnin në nëntor, ndërsa kualifikimet zgjasin deri më 10 janar 2022. Kiana ka nisur të merret me skijim prej moshës trevjeçare si pasion familjar, ndërsa profesionalisht prej moshës 11. "Unë jam rritur duke bërë ski. Është një sport që e kam pasion thellë në zemër". Idhull të saj

janë Petra Vlhova, Alice Robinson dhe Lara Gut Behrami, me të cilat mund të jetë në gara gjatë LOD Pekini 2022. Ajo është Shpresë Olimpikë 2021, me ç'rast nga KOK-u merr nga 150 euro në muaj. Kiana bashkë me skitarët e tjerë, Arbi Pupovci e Drin Kokaj, ndodhen në Hintertux të Austrisë, ku po përgatiten bashkë me trajnerin Agim Pupovci. Atyre do t'u bashkohet edhe skitari tjetër Albin Tahiri. LOD Pekini 2022 mbahen prej 4-20 shkurt të vitit të ardhshëm. Për ekipin olimpik të Kosovës do të jenë Lojërat e dyta Olimpikë, pas debutimit në PyeongChang 2018 me Albin Tahirin.

Simeone: Kloppin do ta përshëndes në ndeshjen e kthimit

MADRID, 20 TETOR - Trajneri Diego Simeone u kritikua pas humbjes së Atletico Madridit nga Liverpooli pasi refuzoi t'ia jepte dorën Jurgen Kloppit. Simeone vrapoi në tunel sapo ndeshja u mbyll dhe kjo nuk i

pëlqeu aspak mediave britanike. Lidhur me këtë veprim, Simeone ka deklaruar se nuk ia zgjatë dorën gjithmonë trajnerëve në fundin e takimit, por do të përshëndetet me Kloppin në

ndeshjen e radhës. "Nuk i përshëndes gjithmonë trajnerët pas ndeshjes sepse nuk më pëlqen. Nuk është e mirë as për fituesin ose humbasin. Unë mendoj në atë mënyrë. Por, kur ta takoj në

ndeshjen e kthimit, do ta përshëndes pa problem", ka thënë Simeone. Liverpooli mban kreun e grupit B me 9 pikë, e ndjekur nga Atletico Madridi me 4, teksa ndeshja e kthimit pritet të sjellë



Policia e Kosovës: Ademi u sulmua nga pesë persona

PRISHTINË, 20 TETOR - Policia e Kosovës ka dhënë detaje për sulmin ndaj kryetarit të Federatës së Futbollit të Kosovës Agim Ademi. Sipas këtij njoftimi nga Policia e Kosovës, kreu i FFK-së u sulmua nga pesë persona. Ademi në momentin kur ndodhi sulmi ishte i shoqëruar edhe nga një person tjetër. Sipas policisë, një nga të dyshuarit kishte shtënë një herë me armë, por në vendin e ngjarjes nuk është gjetur ndonjë gëzhjojë ose diçka e dyshuar. "Dy ankuesit meshkuj kosovarë kanë njoftuar se deri sa ishin duke ecur kanë hasur në pesë persona të dyshuar dhe janë sulmuar fizikisht nga të njëjtit. Një nga të dyshuarit ka shtënë një herë me armë zjarri. Njësitë policore në vendin e ngjarjes ka kryer ekzaminimin, por nuk ka gjetur ndonjë gëzhjojë apo diçka tjetër të dyshuar. Një nga ankuesit ka pësuar lëndime



të lehta trupore dhe ka pranuar tretman mjekësor. Rasti është duke u hetuar".

Agim Ademi dje u sulmua në "Parkun e Gërmisë" rreth orës 8:00 të mëngjesit. Ademi deklaroi se persona që e sulmuan atë ishin të maskuar. "Është e vërtetë që sot rreth orës

8:00 jam sulmuar fizikisht nga persona të maskuar në parkun e Gërmisë, aty ku çdo ditë e praktikoj ecjen dhe vrapimin në natyrë. Personat në fjalë më sulmuan në mënyrë tinëzare por që, fatmirësisht, kalova pa lëndime serioze", ka deklaruar Ademi.

Curry, 'leksion' lakersave, Milwaukee mposhti rivalët e Brooklynit

MILWAUKEE, 20 TETOR - Ka startuar sezoni 2021-2022 në NBA dhe surprizat nuk kanë munguar që në mbrëmjen hapëse. Skuadra kampione e Milwaukee Bucksit mposhti 127-104 Brooklyn Netsit, sfidë mes dy ekipeve pretendente për titullin këtë sezon. Mungesa e Irvingut u ndje te Netsi, ku më i miri ishte Durant me 32 pikë, mbështetur edhe nga Millsi me 21 pikë e Hardeni me 20 pikë. Në kahun tjetër shkëlqeu i zakonshmi Giannis Antetokounmpo, me 32 pikë e 14 rebounde, ndërsa Middletoni e Connaughtoni realizuan nga 20 pikë secili. Befason Golden State, që mundi 121-114 lakersat jashtë fushës. Vijon kriza e ekipit të lakersave, pa asnjë fitore që nga nisja e fazës përgatitore. Stephen Curry realizoi një "triple double" me 21 pikë, 10 rebounde dhe 10 asistime, më i miri në fushë.



Vendimtar stoli për miqtë, me 55 pikë. Për lakersat, LeBron Jamesi realizoi 34 pikë dhe 11 rebounde, ndërsa Anthony Davis 33 pikë e

11 rebounde, por që s'mjaftuan për ta evituar humbjen. Pjesa tjetër e skuadrës ishte thujse inekzistente në parket.

SHKURT

Gjasula, fansave kuqezi: Faleminderit për mbështetjen, shihemi në nëntor!

Klaus Gjasula ishte mungesa e madhe e Kombëtares Shqiptare në ndeshjen vendimtare ndaj Polonisë dhe shkak u bë infektimi nga koronavirusi, pikërisht në grumbullimin me kuqezinjtë. Nga Gjermania mesfushori ka zgjedhur një videomesazh për t'i falënderuar të gjithë njerëzit që e kanë mbështetur gjatë ditëve të vështira të luftës me koronavirusin dhe u ka lënë takim në nëntor. "Përshëndetje! Ju falënderoj të gjithëve për mbështetjen dhe komentet pozitive në këto ditë të vështira që kam kaluar dhe shihemi në nëntor", thotë mesfushori në mesazhin e tij për fansat kuqezi. Shqipëria do të luajë dy ndeshjet e fundit eliminatore në nëntor, konkretisht më 12 ndaj Anglisë në "Wembley" dhe tri ditë më vonë ndaj Andorrës në "Air Albania". Gjasat për një kualifikim të mundshëm në fazën "play-off" janë thujse minimale, pasi ekziston vetëm një kombinim matematik që e nxjerr të dytën, por edhe gati-gati e pamundur të ndodhë.

Shkarkohet Bruce

Sheikët arabë të klubit të Newcastle Unitedit e kanë nisur menjëherë me "dorë të hekurt" teksa kanë larguar në mënyrë konsensuale nga detyra e trajnerit Steve Bruce. Fatale për trajnerin e njohur britanik janë rezultatet negative dhe renditja e skuadrës në vendin e parafundit në kuotën e tri pikëve. Lajmin e largimit të Steve Bruce në bankinën e Newcastleit e ka bërë vetë klubi bardhezi me anë të një komunikate në sajtin e saj zyrtar, ku njoftojnë se pasuesi i tij i përkohshëm do të jetë Grem Xhons duke filluar që nga ndeshja e Premierë Ligës të së shtunës ndaj Crystal Palace në transfertë. Më parë tekniku 60-vjeçar ka qenë pjesë edhe e ekipeve si: Aston Vila, Hull City, Wigan, Birmingham dhe Crystal Palace. Nuk mungojnë kandidatët për bankinën e skuadrës së Newcastle Unitedit teksa shumë pranë ishte dhe Antonio Conte i cili ndodhet pa klub që pas largimit nga Interi në maj të këtij viti.

Pioli: Mund të kualifikohemi

AC Milan nuk po tregon formë të mirë në Ligën e Kampioneve pasi ka regjistruar humbjen e tretë. Skuadra kuqezi mbrëmë është mposhtur nga Porto (1-0), por trajneri Stefano Pioli ende vazhdon të jetë optimist sa i përket çështjes së kualifikimit. "Normalisht duhet të besojmë, por duhet thënë se në fushë do të jetë e vështirë. Kemi zero pikë, por ekipet e dyta janë në kuotën e 4 pikëve, nuk janë shumë larg. Ndaj Portos gabuam në mënyrën e lojës që zgjodhëm, tani të fokusohemi në kampionat dhe më pas të mendojmë me qetësi për Ligën e Kampioneve", ka thënë Pioli.

Ancelotti: Do të jetë më ndryshe ndaj Barcelonës

Në ndeshjen e radhës Real Madridi do të përballet me Barcelonën në "Camp Nou" dhe trajneri Carlo Ancelotti është optimist, posaçërisht pas fitores me 5-0 në terrenin e Shahtjor Donjetskut. Tekniku italian tha se ky trepikësh jep besim, por ndeshja ndaj Barcelonës do të jetë plotësisht më ndryshe. "Të gjithë përformuan mirë. U mbrojtëm mirë. Ishim fokusuar, e bëmë strategjinë e duhur dhe u rikthyem në mbrojtje kur ata ishin në kundërsulme. Kjo fitore na jep besim, por ndeshja ndaj Barcelonës do të jetë ndryshe dhe do të jetë tregim tjetër. Është e rëndësishme që mbajmë porën e paprekur. U mbrojtëm mirë. Të gjithë ia dolën mirë individualisht sepse të gjithë punuan shumë", ka deklaruar trajneri Ancelotti. Të dielën, në orën 16:15, në stadiumin "Camp Nou", do të zhvillohet "El Clasico".

Mbappe: Messi është lojtari më i mirë në botë

Sulmuesi i PSG-së, Kylian Mbappe, ka thënë se Leo Messi është lojtari më i mirë në botë. Sulmuesi francez ka vlerësuar se është e drejtë që

Messi është ekzekutues i parë i penalltive. "Është normale, është çështje respekti, është futbollisti më i mirë në botë, është një privilegj që të luajë

me ne, gjithmonë e kam thënë këtë. Nëse ka një penallti, do ta gjuajë ai dhe pikë. Në rastin e penalltisë së dytë, ma dha vetë, më tha

mere përsipër, ishte fundi i lojës dhe unë e aprovova zgjedhjen e tij", ka thënë Mbappe. PSG-ja e mposhti të martën në mbrëmje Leipzig

(3-2) dhe në këtë ndeshje Messi realizoi një gol nga penalltia, derisa Mbappe e humbi një penallti në fund të ndeshjes.

Gjimnazi "Hamdi Berisha" në Malishevë

Nr: 296/21
Datë: 20.10.2021.

Gjimnazi "Hamdi Berisha", shpallë:

FTESË PER OFERTË

QËLLIMI: Sigurimi i uniformës për nxënësit e klasëve të **X-ta**

Kriteret: Uniforma duhet të jetë për meshkuj vetëm **pallto** me emblemë të shkollës, si dhe për femra **pallto** duhet të jetë me emblemë me kalkan dhe e gjatë deri tek gjuri dhe, çmimi i volitshëm dhe mundësitë për një çmim më të arsyeshëm për nxënës me ekonomi të dobët familjare.

Ofertuesit duhet t'i ofrojnë modelet e tyre në shkollë. Ofertat dorëzohen në administratën e shkollës (sekretari i shkolles) deri më 27.10.2021, ditë e Mërkurë në orën 14:00 kur do të hapen ofertat në prani të komisionit.

Gjimnazi "Hamdi Berisha" në Malishevë, i ka mbi 450 nxënës, meshkuj 200 femra 250.

Për informata të tjera mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 044 269-758

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se "Italian Pizza" SH.P.K. ka marrë vendim të shuajë biznesin me nr: 811582081, dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditorë - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa "Italian Pizza" D.O.O. donelo odluku o prestani rada sa nrb: 811582081, ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potrazivanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavlivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

All clients are to be informed that the "Italian Pizza" L.L.C. has come to the decision to quit its business: 811582081 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager - mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se "Ring-A" SH.P.K. me pronar Ennal Ahmetaj, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nr: 810972655, dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditorë - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa "Ring-A" D.O.O. Ennal Ahmetaj donelo odluku o prestani rada sa nrb: 810972655, ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potrazivanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavlivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

All clients are to be informed that the "Ring-A" L.L.C. Ennal Ahmetaj has come to the decision to quit its business: 810972655 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager - mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook

www.facebook.com/gjejpuneshepte

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË



European
Union
Kosovo



Standard advertisement for local publication of local open tender procedures

Purchase and install of innovative automatic vertical packaging machine, model for frozen fruits based on multi-head weigher

CN. 2019-413-972

JONI-SH SH.P.K. intends to award a supply contract for the action/grant "Improved competitiveness through modernization of the collection center for Berry fruits" located at the official address Str. "Ali Ajeti" n.n. Ballofc village, 11000 in Podujeva, with financial assistance from the European Union, represented by the European Union Office in Kosovo.

The tender dossier is available for inspection at the above-mentioned address and in the e-mail addresses: jonishshpk@gmail.com & info@joni-sh.com or phone no.: +383 45 548 852

The deadline for submission of tender is on 04.12.2021 at 15:00 hrs. at the following Address "JONI-SH SH.P.K., facility at the following address: Str. "Ali Ajeti" n.n., Ballofc village, 11000 Podujeva, Kosovo

Any possible additional information or questions related to announced action to will be clarified in the tender dossier available in above mentioned addresses, published e-mails or phone number.

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 03/L-214, për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 20, pika 2 dhe 4, Kompania "Trofta Fresh" Sh.p.k. Dobërçan, Gjilan, në bashkëpunim me Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapsinor dhe Infrastrukturës, organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për hurdhën për rritjen e peshkut në Dobërçan, Gjilan.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 11.11.2021 në ora 13:00 në Restaurant Planeti në Fshatin Kmetovc, Komuna Gjilan do të organizohet debat publik nga Kompania "Trofta Fresh" Sh.p.k. Dobërçan, Gjilan, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapsinor dhe Infrastrukturës.

Debati publik do të organizohet për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për hurdhën për rritjen e peshkut në Dobërçan, Gjilan.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën

ZOOM

<https://www.google.com/maps/place/Kmetoc/@42.4892668,21.5266799,14z/data=!4m2!3m1!1s0x1354ed8264894b13:0x9d482bd409cf5d0c?force=pwa&source=mlapk>

Username

9662771284

Paswordi

112233

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për kompaninë "Trofta Fresh" Sh.p.k. Dobërçan, Gjilan për hurdhën për rritjen e peshkut në Dobërçan, Gjilan

https://mea.rks-gov.net/dokumentet_dhe_publicimet/279/publicimet

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon në implementimin e projektit.

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 03/L-214 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 20, pika 2 dhe 4, Kompania "Edmond A. Hasani B.I. " Vushtri, në bashkëpunim me Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapsinor dhe Infrastrukturës, organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për impiantin për stacionin e karburanteve në Rr.Gj.K. Skënderbeu, Vushtri. Njoftohet publiku i interesuar se më datën 11.11.2021 në ora 11:00 në Lokalet e biznesit Edmond Hasani B.I në Rr.Deshmoret e Kombit - Vushtri, do të organizohet debat publik nga Kompania "Edmond A. Hasani B.I. " Vushtri, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapsinor dhe Infrastrukturës.

Debati publik do të organizohet për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për stacionin e karburanteve në Rr.Gj.K. Skënderbeu, Vushtri.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM

Linku:

<https://us05web.zoom.us/j/6926287536?pwd=MGpINVVuOGNCR0lQk9UcUcAxeEhmZz09>

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për kompaninë "Edmond A. Hasani B.I. " Vushtri për impiantin për stacionin e karburanteve në Rr.Gj.K. Skënderbeu, Vushtri.

https://mmphi.rks-gov.net/dokumentet_dhe_publicimet/279/publicimet

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon në implementimin e projektit.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

► Fton Mahmutaj shpall të pavlefshme dëftesën e plotë SH.F.M.U. "Yll Morina" nga kl. I-V dhe VI-IX.

► Sedat Berisha shpall të pavlefshme diplomën e SH.M. Teknike "Nexhmedin Nixha" Konfeksion.

► Bernardina Alijaj nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. I, II, III, IV dhe diplomën e shkollës së mesme të mjekësisë "Hysni Zajmi" drejtimi Farmaci Gjakovë.

► Xhevdet Dervishaj nga Nasheci i Prizrenit, shpall të pavlefshme Diplomën e studimeve themelore universitare të lëshuar nga Kolegji "Dardania", drejtimi: Banka, Financa dhe Kontabilitet.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.

► Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.

► Lëshoj banesë me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.

► Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

► Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

► Urgjentisht kërkoj një banesë me qira ne Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

► Lëshoj lokalit më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275



ROYAL CROWN;
RC
cola

ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales